REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Kryeministri

U R DH Ë R

Nr. 71 **, datë** 21.7.2011

PËR

NGRITJEN DHE FUNKSIONIMIN E GRUPIT NDËRINSTITUCIONAL TË PUNËS PËR NDJEKJEN E PROCEDURAVE TË ANËTARËSIMIT TË SHQIPËRISË NË NISMËN PËR TRANSPARENCË NË INDUSTRINË NXJERRËSE (EITI)

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës, dhe të pikës 1, të nenit 12, të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave",

U R DH Ë R O J:

1. Ngritjen dhe funksionimin e grupit ndërinstitucional të punës, për ndjekjen e procedurave të anëtarësimit të Shqipërisë, si vend zbatues i Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse, dhe plotësimin në vazhdimësi të detyrimeve të kësaj nisme.

2. Grupi i punës të kryesohet nga zëvendësministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe në përbërje të ketë këta anëtarë:

   a) Një përfaqësues nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës;
   b) Një përfaqësues nga Ministria e Financave;
   c) Një përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë;
   ç) Një përfaqësues nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve;
   d) Një përfaqësues nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore;
   dh) Një përfaqësues nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar;

e) Pesë përfaqësues nga biznesi, të përzgjedhur nga Rrjeti Kombëtar i Industrisë Nxjerrëse;
ë) Pesë përfaqësues nga shoqëria civile, të përzgjedhur nga Rrjeti Kombëtar për Shoqërinë Civile për EITI - në.

Niveli i përfaqësimit në këtë grup për institucionet shtetërore do të jetë jo më i ulët se drejtor drejtorie.

3. Me ftesë të kryetarit, në mbledhjet e këtij grupi mund të marrin pjesë përfaqësues nga institucione të tjera.

4. Institucionet e përmendura në pikën 2 të dërgojnë, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij urdhri, pranë kryetarit të këtij grupi, emrat e personave përfaqësues.

5. Sekretariati i Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse (EITI) përgatit projektin e rregullores për funksionimin e bordit drejtues të sekretariatit të Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse (EITI), që miratohet nga ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

6. Urdhri nr.156, datë 27.12.2008, i Kryeministrit, "Për ngritjen dhe funksionimin e grupit ndërinstitucional të punës për ndjekjen e procedurave të kandidimit të Shqipërisë në Nismën për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse (EITI)", shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

SALI BERISHA